



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.553/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri Kryesues dhe Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Gentiana Krasniqi duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Sami Lushtaku, kandidat për kryetar komune në Skenderaj nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së Nr.2114-2021 të datës 28.08.2021 për shkak të mos certifikimit për pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale 2021 që do të mbahen me 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 01.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli Anr.553/2021 i datës 29.08.2021, i parashtruar nga Sami Lushtaku, kandidat për kryetar komune në Skenderaj nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur ndaj Vendimit të KQZ-së së Nr.2114-2021 të datës 28.08.2021 për shkak të mos certifikimit si kandidat për kryetar Komune nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për pjesëmarrjen në Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 29.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Sami Lushtaku, kandidat për kryetar Komune në Skenderaj nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në të cilin pretendon se iu është bërë e padrejtë moscertifikimi i tij në bazë të vendimit të KQZ-së Nr.2114-2021 të datës 28.08.2021 pasi që sipas këtij vendimi është bërë shkelje e dispozitave kushtetuese dhe ligjore ngase arsyeja e mos certifikimit të tij qëndron në faktin se i njëjti është shpallur fajtor dhe ndaj tij është marrë Aktgjykim dënues i shpallur në tri (3) vitet e fundit, i cili dënim ka qenë vetëm me gjobë dhe si i tillë ky aktgjykim nuk krijon pasoja juridike ngase në momentin e pagesës shlyhet nga evidenca e të ndëshkuarve andaj edhe i njëjti pretendon se ky vendim i KQZ-së është antikushtetues dhe i paligjshëm dhe për më tepër konsideron se vendimi i atakuar me këtë ankesë përmban shkelje kushtetuese dhe ligjore dhe se përmes këtij vendimi nuk është bërë vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike.

Nga të gjitha këto pretendime parashtruesi i apelit z.Sami Lushtaku nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kërkuar nga PZAP që lidhur me ankesën e parashtruar të bie vendim me të cilin do ta aprovoi në tërësi ankesën e paraqitur kundër Vendimit Nr.2114-2021 të datës 28.08.2021, dhe ta prish vendimin e lëshuar nga KQZ, për mos certifikimin e kandidatit Sami Lushtaku nga PDK, ashtu që ti lejohet z.Lushtaku që të kandidoj në zgjedhjet lokale të datës 17 tetor 2021, me të drejta të plota të garantuara me kushtetutë dhe ligj.

PZAP-i me datën 29.08.2021 ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kërkesën për përgjigje në ankesë.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike ZRPPC-KQZ ka dërguar përgjigjen në ankesë më datën 30.08.2021, në të cilën theksohet se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), që të bëjë verifikimin e kandidatëve nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) që marrin pjesë në garë zgjedhore për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me 17 tetor 2021, nëse të njëjtit janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykatat e Republikës së Kosovës. Me datë 22 gusht 2021, Zyra/KQZ, ka pranuar nga KGJK, shkresën me të cilën identifikohet edhe ky kandidat, në këtë rast z.Sami Lushtaku, kandidat për kryetar komune në Kuvendin Komunal në Skenderaj nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e në të cilën përgjigje theksohet se z.Sami Lushtaku është i dënuar me Aktgjykim të plotfuqishëm PKR.685/2016 të datës 30.10.2020, PKR.948/2020 të datës 13.01.2021 dhe P.197/2018 të datës 18.07.2019.

Subjekti politik PDK, me datë 23 Gusht 2021, për kandidatin e cekur është njoftuar për informatën që Zyra ka pranuar nga KGJK, dhe i është dhënë afat për të dërguar zëvendësimin në të kundërtën do rekomandon mos certifikimin e tij dhe se PDK e ka bërë zëvendësimin ashtu që KQZ, ka certifikuar kandidatin e zëvendësuar me datë 28 gusht 2021 me vendimin e KQZ-së Nr.2114/2021.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj apelin, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoj lejueshmërinë e apelit dhe ka arritur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit se me rastin e marrjes së vendimit nga KQZ-ja, lidhur me refuzimin për certifikimin e tij nga gara e listës së kandidatëve për kryetar komune në Kuvendin Komunal në Skenderaj në zgjedhjet lokale të datës 17 tetor 2021 i është bërë e pa drejtë pasi që iu është shlyer dënimi nga evidenca e të dënuarve, Paneli i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, sepse neni 29 par.1 pika q) i LZP-së, përcakton se cilido person, emri i të cilit paraqitet në Listën e Votuesve, është i përshtatshëm për certifikim, përveç nëse personi është shpallur fajtor për veprë penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit, siç edhe është në rastin konkret ngase parashtruesi i apelit me Aktgjykimet e plotfuqishme PKR.685/2016 të datës 30.10.2020, PKR.948/2020 të datës 13.01.2021 dhe P.197/2018 të datës 18.07.2019 është verifikuar si person i dënuar.

Mbi këtë bazë, Paneli konstaton se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit Nr.2114-2021 të datës 28.08.2021 drejt ka zbatuar dispozitën ligjore të nenit 29 par. 1 pika q) të LZP-së, pasi që i njëjti është shpallur fajtor për veprë penale me aktgjykim përfundimtar në tri (3) vitet e fundit, sipas Aktgjykimeve të plotfuqishme PKR.685/2016 të datës 30.10.2020, PKR.948/2020 të datës 13.01.2021 dhe P.197/2018 të datës 18.07.2019 dhe se me vendimin Nr.2114-2021 të datës

28.08.2021 lëshuar nga KQZ është certifikuar lista me kandidatë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e rekomanduar nga ZRPPC me të cilën i njejtë nuk është i përfshirë në listën e rekomanduar dhe çdo pretendim në apel mbi këtë bazë është i paqëndrueshëm.

Fakti se parashtruesi i apelit pretendon se dënimi i shqiptuar është shlyer nga evidenca e te dënuarve, për Panelin rrethanat e tilla nuk krijojnë mundësi për përshtatshmërinë e kandidatit bazuar në kufizimet e përcaktuara në nenin 29 par 1 pika q) të LZP-së, nga se kjo dispozite ka përcaktuar tri kritere, që të jetë shpallur fajtor për vepër penale, që të jetë dënuar në tri vitet e fundit dhe që vendimi të jetë i formës së prerë, për pasojë në rastin konkret që të tri këto kritere ligjore plotësohen dhe shlyerja nga evidenca e te dënuarve ka efekt për të drejtat që janë humbur si pasojë e dënimit penal, ndërsa sipas LPZ-së, për tu certifikuar kandidati për deputet duhet shikuar vetëm se a plotësohen këto tri kritere ligjore nga neni 29.1. pika q) të LZP-së, kritere këto ligjore të mbivendosura në zbatim për zgjedhjet që organizohen në Kosovë, sipas dy vendimeve dhe atë, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KO95/2020 i datës 06.01.2021, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, nr. AA.nr. 4/2021 i datës 28.01.2021.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika b) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në pajtim me nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1, 118.5 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 553/2021 më datën 01.09.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.